



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E APELIT
TIRANE

Bulevardi "Zhan D'Ark" Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax 00 355 04 2260284

URDHËR

Nr. 63, datë 15.4.2013

"Mbi zbatimin e Udhëzimit nr. 282, datë 15.06.2012 të Ministrit të Drejtësisë "Për mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio"

Ne mbeshtetje të nenit 18, të Ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", Rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Gjyqësore", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 1830, datë 03.04.2001, dhe në zbatim të Udhëzimit nr. 282, datë 15.06.2012 të Ministrit të Drejtësisë "Për mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio"

URDHËROJ

1. Te zbatohet Udhëzimi nr. 282, datë 15.06.2012 i Ministrit të Drejtësisë "Për mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio", në mënyrë të detyrueshme nga ana e Gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Te zbatohet neni 3/3 i këtij Udhëzimi, nga sekretaret gjyqësore në mënyrë të detyrueshme.
3. Të njoftohet Ministria e Drejtësisë për fillimin e zbatimit të këtij Udhëzimi sipas nenit 25 të tij.
4. Ngarkohet Kancelari i Gjykatës së Apelit Tiranë të ndjekë dhe njoftojë Drejtorinë e Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë për njoftimin, ndjekjen dhe zbatimin e tij.
5. Një kopje e këtij Urdhri dhe e Udhëzimit t'i vihet në dispozicion Gjyqtarëve dhe Sekretarëve Gjyqësorë.

Ky urdher hyn në fuqi menjehere.

KRYETARI

ALAUDIN MALAJ